



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2023:003677

Datë: 16.01.2023

Numri i dokumentit: 03858802

CN.nr.02/2023

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Naim Rekalu, në çështjen juridike të propozuesit L. B. me vendbanim në G. duke vendosur lidhur me propozimin për pranimin e vendimit të gjykatës së huaj, jashtë seance, me datë 16.01.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Dresden, Gjermani, i plotëfuqishëm që nga data 02.04.2014, me numër të lëndës 303 F 1544/13, me të cilin është zgjidhur martesë e lidhur më 18.03.2015, në mes propozuesit L. B. i lindur me datën 10.06.1983, me vendbanim në Gjermani dhe M. B. e lindur më 16.08.1985.

A r s y e t i m

Propozuesi L. B. me vendbanim në Gjermani, me datë 06.01.2023, pranë kësaj gjykate ka parashtruar propozimin për pranimin e aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Dresden, Gjermani, me numër 303 F 1544/13, i plotëfuqishëm nga data 02.04.2014, me të cilën është zgjidhur martesë në mes L. B. dhe M. B.

Me shikimin e aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Dresden, Gjermani, me numër 303 F 1544/13 është vërtetuar se palët e kanë zgjidhur martesën. Vendimi në fjalë është i plotëfuqishëm nga data 02.04.2014..

Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Dresden, Gjermani, është dokument zyrtar i shtetit të huaj. Gjykata Themelore Mitrovicë-Dega në Vushtrri në bazë të nenit 101 al. 1 lidhur me nenin 86, 87 dhe 92 al, 2 të Ligjit mbi Zgjidhjen e Konfliktëve të Ligjeve me dispozitat e vendeve të tjera në raportet e caktuara (Gazeta Zyrtare nr. 43/82), i cili aplikohet në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 1999/24, si dhe nr. 2000/59, mbi ndryshimin e Rregullores nr. 1999/24, të PSSP-së të OKB-së, si dhe Ligjit mbi Gjykatat, vërteton se janë plotësuar kushtet për njohjen e vendimit në fjalë.

Nga arsyet e lartcekura u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

CN.nr.02/2023, datë 16.01.2023

Gj y q t a r i
Naim Rekalio

UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: Ky aktvendim është i formës së prerë, në kuptim të nenit 177.1, të Ligjit 03/-L006, për Procedurën Kontestimore.